



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FIER
NJËSIA E PROKURIMIT

Nr. _____ Prot.

Fier, më _____, 02.2026

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Blerje materiali (konglomerat) për rehabilitimin (riparimin) e argjinaturave lumore për mbrojtjen nga lumi Vjosë, të Bashkisë

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):
Zhavorr, rërë, gurë të grimcuar dhe aggregate 14210000-6, Argjilë 14221000-6

VLERA E FONDIT LIMIT: 4 159 974 (katër milion e njëqind e pesëdhjetë e nëntë mijë e nëntëqinde shtatëdhjetë e katër) **lekë pa TVSH**, vënë në dispozicion nga Buxheti i Bashkisë Fier dhe buxheti i Qendrës Ekonomike të Arsimit Fier.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor, Bashkia Fier, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 4;

Argumentimi: Ky kriter u vendos sipas nenit 83 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, ku përcaktohet se:

Pika 1 e nenit 83: “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël.”

Pika 2 e nenit 83: *“Autoriteti ose enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit:*

a) vlerën e kërkuar të sigurimit të ofertës, e cila duhet të jetë 2% e vlerës së përlogaritur të kontratës;

b) çdo kërkesë për natyrën dhe formën e sigurimit të ofertës,”

si dhe në nenin 30 të VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

b. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit sipas Shtojcës 9;

Argumentimi: Ky kriter u vendos bazuar në nenin 76 të ligjit nr.162/2020, *“Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar dhe nenin 26 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.*

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Kopje të deklaratave të xhiros vjetore, të realizuar nga operatori ekonomik ofertues gjatë 2 (dy) viteve të fundit **(2023, 2024)** lëshuar nga Administrata Tatimore, me vlerë jo më pak se **1 600 000 lekë pa TVSH** (e cila është një vlerë jo më e madhe se 40% të vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet). Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti kontraktor. Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë ky kriter plotësohet nga secili anëtar i bashkimit në raport me përqindjen dhe/ose kushtet e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në përputhje me:

-Pikën 3 të nenit 77 të ligjit nr. 162/2020, *“Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, në të cilin gjejmë të përcaktuar se: “3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.;*

-Pikën 1 dhe pikën 2/c të nenit 43 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, *“Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, ku përcaktohet se:*

Pika 1. *“Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare.”*

Pika 2/c: “2. *Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalohet: c) 40% të vlerës së parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar;*”

Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim që autoriteti kontraktor të sigurohet për aftësinë ekonomike dhe financiare të operatorit ekonomik ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitet ekonomik dhe financiar për të përmbushur kontratën siç është parashikuar nga autoriteti kontraktor. Kriteri i mësipërm është në përpjestim dhe i lidhur ngushtë me objektin e kontratës.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Pika 1 dhe pika 2/c e nenit 43 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “*Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik*”, i ndryshuar, parashikon marzhin maksimal për vlerën e xhiros, që mund të kërkohet në procedurën e hapur të thjeshtuar, përkatësisht; Pika 2/c: “2. *Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalohet: c) 40% të vlerës së parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar;* Duke qënë se kjo procedurë prokurimi është bazuar në vlerën e fondit limit nën kufirin e ulët monetar, autoriteti kontraktor, duke u bazuar në eksperiencën e suksesshme të procedurave të zhvilluara më parë gjykon se është e përshtatshme vendosja e kriterit të marzheve maksimale të përcaktuara në legjislacionin dhe rregullat e prokurimit publik.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 43 të VKM nr.285, datë 19.05.2021, “*Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik*”, i ndryshuar, ku përcaktohet se: “*Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare*”.

Në vendosjen e këtij kriteri është mbajtur në vëmendje neni nr. 61 të Ligjit nr.29/2023 “*Për tatimin mbi të ardhurat*” si dhe rekomandimit të APP-së nr. 7998 date 24.12.2021. Vlera e kërkuar është brenda kufijve të vendosur në dispozitat më sipër, dhe është vendosur me qëllim që AK të sigurohet për potencialin ekonomiko-financiar të OE ofertues, që lidhet drejtëpërdrejtë me qëndrueshmërinë dhe vijimësinë e veprimtarisë së operatorëve ekonomikë në treg, si një element i rëndësishëm në realizimin me sukses të kontratës dhe përmbushjes së detyrimeve kontraktore.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Për të provuar përvojën e mëparshme, kërkohen dëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në këtë rast vlera e kërkuar është jo më pak se **800 000 lekë pa TVSH** (e cila është një vlerë jo më e madhe se 20% të vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet), që është realizuar gjatë tri viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Për këtë pikë Operatori Ekonomik duhet të paraqesë një nga dokumentat e mëposhtëm:

- a- Vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- b- Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenit 40, pika 4 dhe nenit 55 pika 4/b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 800 000 lekë pa TVSH (e cila është një vlerë jo më e madhe se 20% të vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet) që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, pikën 4 të nenit 40 dhe pikën 4/b të nenit 55 të VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën sa 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar. Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim që Autoriteti Kontraktor të sigurohet për aftësinë teknike të operatorit ekonomik ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet përvojës së mëparshme, se zotërojnë kapacitet dhe aftësinë teknike për të përmbushur kontratën siç është parashikuar nga autoriteti kontraktor.

2.3.2 “Operatori ekonomik duhet të disponojë burim të ligjshëm të materialit objekt prokurimi, nga një **karrierë/gurore e pajisur me leje shfrytëzimi të vlefshme, të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Burimi i materialit mund të jetë **karrierë/gurore** për të cilën operatori ekonomik është titullar i lejes së shfrytëzimit të vlefshme **ose të sigurohet nëpërmjet kontratës së furnizimit me një subjekt që disponon lejen e shfrytëzimit të vlefshme**.**

Për këtë pikë, operatori ekonomik duhet të paraqesë **lejen e shfrytëzimit të vlefshme** të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Në rastin kur materiali, objekt prokurimi, do të sigurohet nëpërmjet kontratës së furnizimit me një subjekt tjetër, duhet të paraqesë **kontratën e furnizimit të vlefshme shoqëruar me lejen e shfrytëzimit të vlefshme të subjektit që zotëron karrierën/guroren**.

Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme, nëse e gjykon të arsyeshme, mbi vërtetësinë e tërësisë së informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ofertues për këtë procedurë prokurimi, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me nenin 26, pika 7, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/ç të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë kapacitetet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, si dhe mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Kërkesa për leje shrytëzimi të vlefshme të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, bazohet në një prej parimeve të përgjithshme të përcaktuar në nenin 3 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, konkretisht në pikën 3 të tij, ku përcaktohet: *“Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”*, si dhe në ligjin nr. 10304, datë 15.07.2010 “PËR SEKTORIN MINERAR NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, nenin 20 dhe nenin 24, pika 1, ku përcaktohet: *“Leja e shfrytëzimit me karrierë të mineraleve ndërtimore i jep zotëruesit të saj të drejtën ekskluzive për të hapur dhe për të shfrytëzuar një karrierë të tillë, të përcaktuar, dhe brenda zonës së lejuar për të.”*,

Referuar kërkesave në dokumentat e tenderit dhe legjislacionin në fuqi, kërkohet që operatori ekonomik të garantoj sigurimin e burimit të materialit objekt prokurimi në mënyrë të ligjshme dhe të qëndrueshme për gjithë kohëzgjatjen e kontratës.

Gjithashtu, lihet e hapur mundësia që operatori ekonomik, nëse nuk disponon /nuk është titullar i lejes së shfrytëzimit të karrierës/gurore, mund ta siguroj materialin objekt prokurimi nëpërmjet një kontrate furnizimi të vlefshme ligjërish, të lidhur me një subjekt të pajisur me leje shfrytëzimi të vlefshme, të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, në përputhje me legjislacionin përkatës, leje e cila duhet të jetë bashkangjitur kontratës së furnizimit.

Në këtë kuadër, theksohet se nuk kërkohet detyrimisht që operatori ekonomik ofertues të jetë domosdoshmërisht zotërues i lejes së shfrytëzimit të burimit të karrierës/gurores, për sa kohë ai disponon një të drejtë ligjore furnizimi, e cila garantohet përmes një marrëdhënieje kontraktore të rregullt me subjektin që zotëron lejen përkatëse.

Vendosja e këtij kriteri, është në përpjesëtim dhe i lidhur ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës, pasi garanton:

- sigurimin e burimit të materialit objekt prokurimi në mënyrë të ligjshme
- sigurimin e vazhdueshëm të kërkesave sasiore të përcaktuara në dokumentet e tenderit
- respektimin e standardeve dhe normave ligjore në fuqi.

2.3.3 Operatori/ët ekonomik duhet të deklarojë nëpermjet paraqitjes së një deklarate se merr përsipër të realizojë furnizimin e mallit objekt prokurimi (përfshirë kryerjen e shërbimit të transportit deri në argjinaturë), sipas kërkesave të Autoritetit Kontraktor dhe brenda afatit kohor të përcaktuar nga AK.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 40 të VKM nr 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”. Ky vetdeklarim kërkohet për ti vertetuar dhe garantuar AK-së realizimin me sukses të kontratës përsa i përket dorëzimit të mallit ne objekt prokurimi.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike dhe termat e referencës janë hartuar nga grupi i punës i ngritur me Urdhërin nr. 262/1 prot., datë 09.01.2026, të Titullarit të Autoritetit Kontraktor, të përcella me shkresën nr. 262/3 prot., datë 13.01.2026 (bashkëngjitur DST në SPE), si dhe në përputhje me nenin 4, pika 38/b, nenin 36 të ligjit nr.162/2020, “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, nenin 40, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Specifikimet teknike nuk kanë asnjë kerkese apo reference të ndonjë marke apo emri të veçantë, patente, vizatim ose tip ose origjinë ose prodhim specifik, përveç kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme e saktë ose e kuptueshme e pershkrimit të kërkesave me kusht qe fjala “ose ekuivalent” përfshihet detyrimisht në këto specifikime.

Shenim : Në çdo rast kur në specifikimet teknike dhe preventive mund të jetë përdorur si referencë emri i ndonjë marke apo emri të veçantë, patente, vizatim ose tip ose origjinë ose prodhim specifik , përfshihet dhe fjala “ose ekuivalent” i saj.

Njësia e Prokurimit